



**HEKURUDHAT E KOSOVËS TRAINKOS SH.A.**

# **RAPORT**

## **Tetor – Dhjetor 2025**



**FUSHË KOSOVË,**  
**Janar 2026**

## PËRMBAJTJA

I.	HYRJE .....	3
II.	STRUKTURA ORGANIZATIVE E HK-TRAINKOS SH. A. ....	4
III.	TREGUESIT E RAPORTIT FINANCIAR .....	7
III.1	Gjendja financiare Tetor – Dhjetor 2025 .....	7
III.1.1	Të hyrat .....	7
III.1.2	Shpenzimet .....	8
III.2	Gjendja në para të gatshme – raporti sipas bankës më 31.12.2025 .....	11
III.3	Transaksionet e realizuara ( Tetor – Dhjetor 2025) .....	11
III.4	Bilanci i gjendjes (31.12.2025).....	14
IV.	TRANSPORTI I UDHËTARËVE .....	15
IV.1	Pasqyra e performancës operative dhe financiare në TU .....	15
IV.2	Numri i trenave, tren kilometër (t/km) dhe udhëtarë kilometër (u/km) .....	16
IV.3	Vonesat e trenave të udhëtarëve .....	16
V.	TRANSPORTI I MALLRAVE .....	17
V.1	Pasqyra e performancës operative dhe financiare në TM .....	17
V.2	Shfrytëzimi i trenave .....	19
V.3	Efektiviteti i trenave .....	20
V.4	Neto-ton & neto-ton-kilometër të transportuar .....	20
V.5	Revokimi i trenave .....	21
VI.	MIRËMBAJTJA E MJETEVE LËVIZËSE – MML .....	22
VI.1	Pasqyra e performancës operative .....	22
VI.2	Spektori i Mirëmbajtjes.....	22
VI.3	Mirëmbajtja e trenave motorikë.....	22
VI.4	Mirëmbajtja e lokomotivave transportuese.....	22
VI.5	Mirëmbajtja e lokomotivave manovruese.....	23
VI.6	Intervenimet në mjetet tërheqëse.....	23
VI.7	Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtarëve.....	23
VI.8	Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave.....	24
VI.9	Riparimi i vagonëve të huaj.....	24
VII.	PROJEKTET DHE PROKURIMI.....	25
VII.1	Projektet kapitale .....	25
VIII.	KONTESTET LIGJORE.....	32
VIII.1	Kontestet ligjore për vitin 2025 .....	32
IX.	AKTIVITETET NË PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESIT .....	33
IX.1	Planifikimi dhe zhvillimi i biznesit.....	33
IX.2	Aktivitetet në transportin e mallrave.....	33
IX.3	Aktivitetet në fushën promovuese.....	34
IX.4	Bashkëpunimi me hekurudhat e vendeve tjera.....	34
IX.5	Pjesëmarrja e HK-Trainkos Sh.A në iniciativat e BE-së.....	35
IX.6	Koordinimi i proceseve me ARH-në, MMPHI-në dhe institucioneve tjera relevante.....	35
X.	Sfidat kryesore gjatë periudhës Tetor – Dhjetor 2025 dhe veprimet për të ardhmen.....	36

## I. HYRJE

---

Raporti për periudhën Tetor – Dhjetor 2025 për HK-Trainkos Sh.A. paraqet angazhimin dhe përpjekjet e vazhdueshme të të gjitha strukturave organizative të Ndërmarrjes, duke përfshirë Bordin e Drejtorëve, Menaxhmentin dhe stafin ekzekutiv, me qëllim të realizimit të rezultateve më të mira të mundshme në kuadër të kushteve dhe kapaciteteve ekzistuese.

Në këtë raport janë të përmbledhura aktivitetet e zhvilluara gjatë tremujorit Tetor – Dhjetor 2025, në funksion të përmbushjes së objektivave të përcaktuara me Planin e Biznesit. Po ashtu, raporti evidenton vështirësitë dhe sfidat me të cilat është përballur Ndërmarrja gjatë kësaj periudhe, të cilat janë të trashëguara edhe nga periudhat paraprake dhe kanë ndikuar drejtpërdrejt në nivelin e realizimit të planifikimeve.


Gjatë kësaj periudhe raportuese, Ndërmarrja është përballur me një sërë sfidash, kryesisht si rezultat i mungesës së kërkesës në treg, veçanërisht në transportin e mallrave, për shkak të mbylljes së Linjës së 10-të Hekurudhore. Kjo mbyllje ka pamundësuar zhvillimin e transportit ndërkombëtar të mallrave përmes hekurudhës, duke ndikuar ndjeshëm edhe në realizimin e transportit të brendshëm të mallrave. Për periudhën Tetor – Dhjetor 2025, nga transporti i mallrave nuk janë realizuar të hyra nga eksporti dhe importi, duke rezultuar me vlerë totale prej 0.00 €. Gjithashtu, nuk janë realizuar të hyra as nga transporti vendor, pavarësisht zotimeve të deklaruara nga kompania Feronikeli.

Transporti i udhëtarëve në linjën Prishtinë – Pejë – Prishtinë ka vazhduar të realizohet me vështirësi të theksuara, kryesisht për shkak të vjetërsisë dhe gjendjes jo të kënaqshme teknike të mjeteve lëvizëse.

Sa i përket transportit të udhëtarëve në linjën Prishtinë – Shkup – Prishtinë (Republika e Maqedonisë së Veriut), qarkullimi i trenit nuk është funksional, për shkak të punimeve që janë duke u zhvilluar në kuadër të rehabilitimit të Linjës së 10-të Hekurudhore, në segmentin Fushë Kosovë – Hani i Elezit. Ndërprerja e qarkullimit do të vazhdojë deri në përfundimin e plotë të punimeve rehabilituese në këtë segment.

## II. STRUKTURA ORGANIZATIVE E HK – TRAINKOS SH. A.

Hekurudhat e Kosovës - Trainkos SH. A. brenda periudhës Tetor – Dhjetor 2025 në numrin e përgjithshëm të të punësuarve ka pasur disa ndryshime të cilat kanë reflektuar edhe në përqindjen e strukturës së përgjithshme të të punësuarve. Në tabelën në vijim do të paraqesim gjendjen e të punësuarve në Ndërmarrje nga data 01.10.2025 deri më 31.12.2025, duke filluar nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, mosha mesatare, punëtorët me kontrata të afatizuara dhe të paafatizuara etj.



Paraqitja statistikore për llojet e kontratave, mosha e të punësuarve, struktura gjinore, struktura nacionale dhe kualifikimi shkollor i të punësuarve në HK-Trainkos - SH. A. është si vijon:

<b>Struktura e të punësuarve në bazë të kategorizimeve të HK - Trainkos - SH.A. më 01 Tetor 2025 dhe më 31 Dhjetor 2025</b>				
<b>Totali i të punësuarve</b>	<b>01.10.2025</b>		<b>31.12.2025</b>	
	<b>148</b>		<b>148</b>	
<b>Vlerat</b>	<b>Vlerat në numra</b>		<b>Vlerat në përqindje</b>	
<b>Datat</b>	<b>01.10.2025</b>	<b>31.12.2025</b>	<b>01.10.2025</b>	<b>31.12.2025</b>
Mosha mesatare e punëtorëve	<b>48.18 %</b>	<b>48.16 %</b>	<b>%</b>	
Në marrëdhënie të rregullt pune	<b>148</b>	<b>148</b>	<b>%</b>	
Meshkuj	<b>127</b>	<b>128</b>	<b>85.81 %</b>	<b>86.49 %</b>
Femra	<b>21</b>	<b>20</b>	<b>14.19 %</b>	<b>13.51 %</b>
Serbë	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>0.68 %</b>	<b>0.68 %</b>
Shqiptarë	<b>147</b>	<b>147</b>	<b>99.32 %</b>	<b>99.32 %</b>
Me shkollim fillor	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>1.35 %</b>	<b>1.35 %</b>
Me PM (përgatitje të mesme) shkollore	<b>78</b>	<b>80</b>	<b>52.70 %</b>	<b>54.05 %</b>
Me kualifikim profesional	<b>20</b>	<b>20</b>	<b>13.51 %</b>	<b>13.51 %</b>
Me përgatitje të lartë	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>1.35 %</b>	<b>1.35 %</b>
Me përgatitje superiore	<b>46</b>	<b>44</b>	<b>31.08 %</b>	<b>29.73 %</b>
Zyrtarët e Lartë	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>2.70 %</b>	<b>2.70 %</b>
Departamenti për Operime Hekurudhore	<b>91</b>	<b>93</b>	<b>61.49 %</b>	<b>62.84 %</b>
Departamenti i Administratës	<b>30</b>	<b>29</b>	<b>20.27 %</b>	<b>19.59 %</b>
Departamenti i Financave	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>2.03 %</b>	<b>2.03 %</b>
Departamenti për Planifikim dhe Zhvillim të Biznesit	<b>8</b>	<b>7</b>	<b>5.41 %</b>	<b>4.73 %</b>
Kabineti i KE-së	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>1.35 %</b>	<b>1.35 %</b>
Zyra e Prokurimit	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>1.35 %</b>	<b>1.35 %</b>
Njësia e Auditimit të Brendshëm	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>0.68 %</b>	<b>0.68 %</b>
Spektori i Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit	<b>7</b>	<b>7</b>	<b>4.73 %</b>	<b>4.73 %</b>

**Vërejtje:** Në tabelën më lartë nuk janë përfshirë anëtarët e Bordit të Drejtorëve.

Gjatë tremujorit Tetor - Dhjetor 2025 në Ndërmarrje ka pasur disa lëvizje/ndryshime të stafit në numrin e përgjithshëm të të punësuarve:

Nr.	Emërtimi	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
1	Aktiv në fillimmuaj	146	147	149	148
2	Të pensionuar	2	0	0	2
3	Të larguar/shkarkuar	0	0	0	0
4	Të dorëhequr	2	1	1	4
5	Të punësuar	5	3	0	8
6	Frekuenca në fundmuaj	151	150	149	
7	Aktiv në fundmuaj	147	149	148	

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme, shihet se numri i përgjithshëm i punëtorëve më datën 01.10.2025 ka qenë 148, ndërsa më datën 31.12.2025 kanë qenë 148 punëtorë.

Muaji Shtator ka përfunduar me 146 punëtorë, i cili ka reflektuar në tabelën e lëvizjeve të punëtorëve, mirëpo gjatë muajit Tetor më datën 01.10.2025 kanë dhënë dorëheqje 2 punëtorë, ndërsa po me datën e njëjtë është pensionuar 1 punëtor, kurse me datën 15.10.2025 është pensionuar edhe 1 punëtor dhe janë pranuar 5 punëtor të rinj, pra kumulativisht punëtor aktiv në fund të muajit Tetor reflekton si 147 aktiv ne fundmuaj, ndërkaq kjo nuk reflekton në tabelën e struktures së punëtorëve e cila rezulton me 148 si aktiv ne fillimmuaj.

### III. TREGUESIT E RAPORTIT FINANCIAR

1. Gjendja financiare Tetor – Dhjetor 2025
2. Gjendja në para të gatshme - raporti sipas bankës (31.12.2025)
3. Transaksionet e realizuara (Tetor – Dhjetor 2025)
4. Bilanci i Gjendjes (31.12.2025)

#### III. 1 Gjendja financiare Tetor – Dhjetor 2025

Për periudhën raportuese Tetor – Dhjetor 2025, gjendja e pozicioneve të të hyrave dhe shpenzime është siç vijon:

##### III. 1.1. Të hyrat

Nga **Transporti i mallrave** kemi realizuar të hyrat në shumë prej 1,985.00€ për periudhën Janar-Dhjetor 2025 nga dy projekte te organizatave te artit dhe kulturës. Totali i të hyrave të planifikuara për vitin 2025 është 250,000.00€ dhe nga kjo del se kemi realizuar 0.79% nga totali. Te hyrat tjera nuk janë realizuar për arsye që linja e 10-të ende qëndron e mbyllur, gjithashtu edhe klienti ynë kryesor Newco Ferronikel nuk është duke realizuar të hyra nga transporti i brendshëm.

**Transporti i Udhëtarëve** për periudhën Tetor – Dhjetor 2025 është realizuar në shumën totale prej 592,850.41€. Prej këtyre të hyrave, nga transporti i kontraktuar me MMPHI për OSHP janë realizuar 363,931.78€, nga të hyrat e planifikuara nga subvencioni për mbulimin e pjesshëm të humbjeve nga trenat tjerë të udhëtarëve nga ME janë realizuar 206,343.72€, ndërsa të hyrat nga biletat janë realizuar në shumën prej 22,574.91€.

Totali i të hyrave të planifikuara nga transporti i udhëtarëve për këtë periudhë raportuese ka qenë 495,068.75€, realizimi i të cilave është arritur në shkallen prej 119.75%.

**Të hyrat nga shërbimet tjera** gjatë periudhës Tetor – Dhjetor 2025 nuk kemi realizuar për këtë periudhë, po ashtu nga RIV-i dhe vendosje e vagonëve në binarë nuk ka realizim.

Të hyrat totale nga kjo kategori kanë qenë të planifikuara në shumën prej 7,500.00€, ndërsa realizimi i tyre është arritur në shkallën prej 0.00%.

**Të hyra tjera** të cilat janë realizuar gjatë periudhës Tetor – Dhjetor 2025, kanë arritur shumën prej 12,528.34€. Këto të hyra janë realizuar në pozicionet si: të hyrat nga shitja e derivateve për HK-Infrakos Sh.A., në shumën prej 6,856.34€, të hyrat nga qiraja në shumën prej 2,542.37€, si dhe të ardhura nga interesi nga llogaria FLEX në vlerë prej 246.37€, lejim financiar është në vlerë 1,503.26 € , të ardhura nga kompenzimi i dëmit është në vlerë 1,380.00€ ,ndërsa nga pozicioni i të hyrave nga shitjet tjera (riparimi i vagonëve) nuk kemi realizuar të hyra në këtë periudhë. Të

hyrat nga kjo kategori, krahasuar me planifikimin prej 21,500.00€, janë realizuar në shkallën prej 58.27%.

### **III. 1.2. Shpenzimet**

**Shpenzimet** për periudhën Tetor – Dhjetor 2025, ashtu edhe siç janë buxhetuar janë të klasifikuara në kategoritë që pasojnë:

**Totali i kostos së shërbimit** për periudhën raportuese është në shumën prej 133,327.84€. Planifikimi i këtyre shpenzimeve për TM4 ka qenë në shumën prej 305,375.00€ dhe arrin kuotën e realizimit në shkallën prej 43.66%.

Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën më poshtë – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Tetor – Dhjetor 2025.

**Shpenzimet e stafit** janë kategori tjetër e rëndësishme e cila ka arritur realizimin në shumën prej 332,956.07€. Këto shpenzime kanë qenë për kategorinë paga dhe kontribute në vlerë prej 332,956.07€ , nuk ka pasur trajnime apo shpenzime tjera. Në total, nëse e krahasojmë shumën e buxhetuar (361,250.00€) për TM4 të vitit 2025, në këtë kategori kemi arritur kuotën e realizimit në shkallën prej 92.17%.

**Totali i shpenzimeve operative** arrin shumën prej 23,470.94€, e cila është realizuar në shkallën prej vetëm 90.01% nga shuma e planifikuar prej 26,075.00€ për TM4 - 2025. Edhe kjo kategori e shpenzimeve sipas grupimeve në kode të posaçme është e precizuar në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Tetor – Dhjetor 2025.

**Totali i shpenzimeve administrative** ka arritur në kuotën prej 23.85%, konkretisht në shumën prej 6,929.69€. Planifikimi për këto shpenzime për TM4-2025 ka qenë në shumën prej 29,050.00€. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Tetor – Dhjetor 2025:


## Të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Tetor – Dhjetor 2025

	EMËRTIMI	Planifikimi Tetor - Dhjetor 2025	Realizimi Tetor - Dhjetor	Diferenca	B/C (%)	Realizimi Tetor - Dhjetor 2024
	A	B	C	D	E	F
<b>A</b>	<b>Shitjet</b>					
1	Transporti i mallrave	250,000.00	1,985.00	248,015.00	0.79	-
2	TU – Ministria e Infrastrukturës	325,000.00	363,931.79	(38,931.79)	111.98	244,104.78
3	TU – Ministria e Ekonomisë	152,568.75	206,343.72	(53,774.97)	135.25	152,568.75
4	TU – Shitja e Biletave	17,500.00	22,574.91	(5,074.91)	129.00	12,435.19
5	Shërbimet tjera	7,500.00	-	7,500.00	-	1,500.00
6	Të ardhurat nga riparimi i vagonëve të huaj	5,000.00	-	5,000.00	-	-
7	Të hyrat tjera jo operative	21,500.00	12,528.34	8,971.66	58.27	16,102.50
<b>I</b>	<b>TOTAL – TË HYRAT</b>	<b>779,068.75</b>	<b>607,363.76</b>	<b>171,704.99</b>	<b>77.96</b>	<b>426,711.22</b>
<b>B</b>	<b>Kostoja e shërbimit/blerjes së materialeve</b>					
1	Derivatet dhe lubrifikantet	193,500.00	72,828.53	120,671.47	37.64	65,893.52
2	Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale	5,375.00	161.34	5,213.66	3.00	3,322.03
3	Inventar dhe pajisje	1,250.00	-	1,250.00	-	128.73
4	Material harxhues	250.00	-	250.00	-	-
5	Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera	15,000.00	11,262.93	3,737.07	75.09	13,020.66
6	Qasja në binarë	80,000.00	42,127.47	37,872.53	52.66	43,219.91
7	Sigurimi i palëve të treta	1,250.00	-	1,250.00	-	-
8	Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj	2,500.00	-	2,500.00	-	-
9	KMSH Nafta Infrakos	5,000.00	6,947.57	(1,947.57)	138.95	8,069.42
10	Servisimi i arkave fiskale	1,250.00	-	1,250.00	-	-
11	Zbritjet e lejuara	-	-	-	-	-
	<b>TOTAL – KOSTOJA E SHËRBIMIT</b>	<b>305,375.00</b>	<b>133,327.84</b>	<b>172,047.16</b>	<b>43.66</b>	<b>133,654.27</b>
	<b>Fitimi (humbja) bruto</b>	<b>473,693.75</b>	<b>474,035.92</b>	<b>(342.17)</b>	<b>100.07</b>	<b>293,056.95</b>
	<b>TË ARDHURAT TJERA</b>					
1	Të ardhurat e jashtëzakonshme	-	-	-	-	-
2	Të hyrat e shtyra (shpenzimet)	-	-	-	-	-
3	Të hyrat nga shitja e skrapit (shitja e aseteve)	-	-	-	-	-
4	Të ardhura tjera (shitja e skrapit-mbeturinat)	-	-	-	-	-
	<b>TOTAL – Të ardhurat tjera</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>#DIV/0!</b>	<b>-</b>

<b>C</b>	<b>Shpenzimet e stafit</b>					
1	Pagat dhe kontributet	361,250.00	332,956.07	28,293.93	92.17	340,318.83
2	Trajnime dhe shpenzime tjera	1,250.00		1,250.00	-	32.50
	<b>TOTAL - Shpenzimet e stafit</b>	<b>362,500.00</b>	<b>332,956.07</b>	<b>29,543.93</b>	<b>91.85</b>	<b>340,351.33</b>
<b>D</b>	<b>Shpenzimet operative</b>					
1	Mirëmbajtje dhe riparime	1,250.00	423.73	826.27	33.90	1,933.33
2	Shpenzimet logjistike	2,500.00	1,117.65	1,382.35	44.71	713.63
3	Energjia elektrike dhe komunal	1,750.00	11,569.12	(9,819.12)	661.09	60.00
4	Kontrollimet sistematike	750.00	1,550.00	(800.00)	206.67	-
5	Marketingu	2,250.00	164.83	2,085.17	7.33	84.75
6	Udhëtimet zyrtare	750.00	-	750.00	-	-
7	Telefonat dhe Posta	2,375.00	1,752.55	622.45	73.79	1,988.74
8	Shërbimet bankare	250.00	228.06	21.94	91.22	157.19
9	Tatimet	10,500.00	223.59	10,276.41	2.13	3,912.00
10	Pajisje elektronike	3,700.00	6,441.41	(2,741.41)	174.09	275.12
	<b>TOTAL - Shpenzimet operative</b>	<b>26,075.00</b>	<b>23,470.94</b>	<b>2,604.06</b>	<b>90.01</b>	<b>9,124.76</b>
<b>E</b>	<b>Shpenzimet administrative</b>					
1	Inventar dhe pajisje	2,500.00	-	2,500.00	-	-
2	Konsulenca dhe auditimi i jashtëm	7,000.00	900.00	6,100.00	12.86	1,200.00
3	Material i zyrës	4,375.00	1,312.46	3,062.54	30.00	1,315.84
4	Material sanitar	1,750.00	212.45	1,537.55	12.14	428.96
5	Qiraja për objektet	3,750.00	1,940.11	1,809.89	51.74	1,547.14
6	Reprezentacioni dhe bufeja	1,000.00	657.77	342.23	65.78	949.19
7	Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet	1,175.00	-	1,175.00	41.00	-
8	Shpenzimet logjistike	5,000.00	1,906.90	3,093.10	38.14	548.95
9	Kontigjente	2,500.00	-	2,500.00	-	-
	<b>TOTAL - Shpenzimet administrative</b>	<b>29,050.00</b>	<b>6,929.69</b>	<b>22,120.31</b>	<b>23.85</b>	<b>5,990.08</b>
	Provizionimi i llogarive të arkëtueshme	-	-	-	-	-
<b>II</b>	<b>TOTAL -SHPENZIMET (B+C+D+E)</b>	<b>723,000.00</b>	<b>496,684.54</b>	<b>226,315.46</b>	<b>68.70</b>	<b>489,120.44</b>
<b>III</b>	<b>Fitimi (Humbja) para zhvlerësimit</b>	<b>56,068.75</b>	<b>110,679.22</b>	<b>(54,610.47)</b>	<b>197.40</b>	<b>(62,409.22)</b>
	<b>GRANTET</b>	<b>102,500.00</b>	<b>97,199.90</b>	<b>5,300.10</b>	<b>94.83</b>	<b>77,488.86</b>
<b>F</b>	<b>Shpenzimet e zhvlerësimit</b>		-			
1	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë rezultat i grante	72,500.00	97,199.90	(24,699.90)	134.07	77,488.86
2	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë nga buxheti i kompanisë	30,000.00	13,380.98	16,619.02	44.60	13,409.98
	<b>TOTAL - shpenzime e zhvlerësimit</b>	<b>102,500.00</b>	<b>110,580.88</b>	<b>(8,080.88)</b>	<b>107.88</b>	<b>90,898.84</b>
<b>G</b>	<b>Fitimi (humbja) nga veprimtaria</b>	<b>26,068.75</b>	<b>97,298.24</b>	<b>(71,229.49)</b>	<b>373.24</b>	<b>(75,819.20)</b>


Tabela Nr. 3.1

**Pjesëmarrja e të hyrave sipas llojit të shërbimit Tetor – Dhjetor 2025**



**Diagrami Nr. 3.2**

**Pjesëmarrja e shpenzimeve sipas kategorive Tetor – Dhjetor 2025**



**Diagrami Nr.3.3**

**III.2. Gjendja në para të gatshme – raporti sipas bankës më 31.12.2025**

Nr.	EMËRTIMI	Saldo 31.12.2025
1.	PCB nr. 1114-004229-0001-59	198.06
3.	PCB (KTh) nr. 1114-004229-0101-50	-

4.	BKK - PCB (K) nr. 1114-004229-0201-41	15.58
5.	BKK - PCB (S) nr. 1114-004229-0301-32	5.20
6.	BKK - PCB (M) nr. 1114-004229-0401-23	1.62
7.	GH-PCB nr. 1114004229050114	27.52
8.	Llog. Kursimeve – FLEX – 1114-0042-2900-0165	301,304.94
	<b>TOTALI</b>	<b>301,552.92</b>

**Tabela Nr. 3.4**

### **III.3. Transaksionet e realizuara Tetor – Dhjetor 2025**

Në tabelat në vijim janë paraqitur transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse, llogarinë e projekteve kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës dhe llogaritë rrjedhëse për subvencione:

<b>Transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse në €</b>	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.10.2025	236.80
Inkasimet e pranuar gjatë muajve Tetor - Dhjetor 2025	489,720.93
Pagesat e kryera gjatë muajve Tetor - Dhjetor 2025	489,759.67
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2025	198.06

**Tabela Nr. 3.5**

<b>Transaksionet në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosoves në €</b>	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.10.2025	1.86
Inkasimet e pranuar gjatë muajve Tetor – Dhjetor 2025	151,343.09
Pagesat e kryera gjatë muajve Tetor – Dhjetor 2025	151,343.09
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2025	1.86

**Tabela Nr. 3.6**

<b>Transaksionet e kompanisë nga subvencionet (MI dhe ME) në €</b>	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.10.2025	9.82
Inkasimet e pranuar gjatë muajve Tetor – Dhjetor 2025	1,151,948.47
Pagesat e kryera gjatë muajve Tetor – Dhjetor 2025	1,151,951.47
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2025	6.82

**Tabela Nr. 3.7**

<b>Transaksionet e kompanisë Llogaria e kursimeve FLEX në €</b>	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.10.2025	145,820.94
Inkasimet e pranuar gjatë muajve Tetor – Dhjetor 2025	864,886.00
Pagesat e kryera gjatë muajve Tetor – Dhjetor 2025	709,402.00
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2025	301,304.94

**Tabela Nr. 3**

**Në tabelën më poshtë janë paraqitur transaksionet më të mëdha gjatë periudhës Tetor - Dhjetor 2025 për deponimet dhe pagesat:**

Deponimet Tetor - Dhjetor 2025			Pagesat Tetor Dhjetor 2025		
Nr.	Emërtimi	Vlera	Nr.	Emërtimi	Vlera
1	Deponim nga ME/Kapitale	151,343.09	1	Pagesa per Pagat 2025	283,226.79
2	Deponim nga MMPHI	605,341.19	2	Pagesa per Kontributeve 2021	152,824.91
3	Deponim nga ME	340,077.28	3	Pagesa per Hib Petrol	142,148.81
4	Deponim nga TU	24,015.00	4	Pagese per Profitech Shpk	120,307.33
5	Deponim nga G.C.F	354.86	5	Pagesa per Kontributeve 2022	53,693.00
6	Deponim nga KMDK	2,771.58	5	Pagesa per Infrakos	32,971.28
7	Deponim Ikonë Studio Shpk	1,416.00	6	Pagesa per Kontributeve tetor-dhjetor -2025	29,792.86
8	Dep. nga komp. i demit nga Kom. SIG.Siguria Risku	1,380.00	7	Pagesa e TVSH-së	17,051.74
			8	Pagesa e Tatimit ne Page	15,516.06
9	Organizata e Artit dhe e Kulturës Prishtina Biennale	926.30	9	Pagese per Elprojekt Shpk	19,993.92
			10	Pagese per Eor Group Shpk	11,870.80
10	Deponim nga SHFMU Pavarësia Prishtinë	337.20	11	Pagese per Ballkan Petrol Shpk	10,080.00
			12	Pagese per Macedonia Railways	7,995.26
11	Deponim nga Llogaria Flex	246.37	13	Pagese per Infosoft Systems Shpk	6,910.21
			14	Pagese per Aeco Consulting Shpk	5,656.92
			15	Pagese per Telekom i Kosoves sh.a - Mobil	2,151.28
			16	Pagese per Instituti I mjeksise ligjore sh.a	1,800.00
			17	Pagese per Sindikatës 1	1,610.53
			18	Pagese per Sindikatës 2	1,193.68
			19	Pagese per Ujë Rugove Shpk	900.06
			20	Pagese per Planet Accounting LLC	900.00
			21	Pagese per Telekom i Kosoves sh.a - Fikse	672.74
			22	Pagese per Europrint Group shpk	563.05
			23	Pagese per ProGlobal Shpk	544.00
			24	Pagese per Probit Shpk	500.00
			25	Pagese per BM SolutionLLC	308.95
			26	Pagese per PM group	304.54
			27	Pagese per ArtMotion Shpk	299.99
			28	Shpenzimet e Bankes	228.06

			29	Pagese per Komp. Mbet. Pastrimi Shpk	155.00
			30	Pagese per Tatim ne qera	153.00
			31	Pagese per Portal Pune Shpk	59.00
			32	Pagese per ndeshkime dhe interes	24.56
			33	Pagese per Posta e Kosoves Sha	18.60
<b>TOTALI</b>		<b>1,128,208.87</b>	<b>TOTALI</b>		<b>922,426.93</b>

Tabela Nr. 3.9

#### III.4. Bilanci i Gjendjes (31.12.2025)

<b>BILANCI I GJENDJES</b>		
<b>NP TRAINKOS SH.A</b>	<b>GJENDJA FILLESTARE 01.01.2025</b>	<b>GJENDJA PERFUNDIMTARE 31.12.2025</b>
<b>Mjetet themelore - vlera neto sipas librave</b>	<b>2,242,734.25</b>	<b>1,892,514.82</b>
<b>Mjetet Qarkulluese</b>	<b>1,012,659.08</b>	<b>834,855.90</b>
Stoqet	420,534.77	465,025.71
Paraja	528,003.53	301,552.92
Llogarite e arketueshme	51,179.71	48,674.84
Kerkesa tjera te arketushme	3,026.72	4,254.63
Parapagimet	9,914.35	15,347.80
<b>Total Mjetet Qarkulluese dhe themelore</b>	<b>3,255,393.33</b>	<b>2,727,370.72</b>
<b>Detyrimet afatshkurta</b>	<b>2,117,841.31</b>	<b>1,832,882.32</b>
Llogarite e pagueshme	754,837.32	666,778.27
Te pagueshme tjera - detyrime	558.44	479.91
Detyrime tatimore	997,482.55	791,074.58
Detyrimet e kredisë	364,963.00	364,963.00
<b>Detyrimet afatgjata</b>	<b>1,554,696.31</b>	<b>1,376,335.32</b>
<b>Kapitali</b>	<b>5,294,036.25</b>	<b>5,292,941.06</b>
Fitimi/Humbja e bartur	-5,222,550.72	-5,711,180.58
Fitim/ Humbja e vitit	-488,629.86	-63,607.39
<b>Total detyrimet dhe kapitali</b>	<b>3,255,393.32</b>	<b>2,727,370.72</b>

Tabela Nr. 4.0

## IV. TRANSPORTI I UDHËTARËVE

### IV.1. PASQYRA E PERFORMANCËS OPERATIVE DHE FINANCIARE NË TU

Gjatë periudhës Tetor-Dhjetor 2025 numri i përgjithshëm i udhëtarëve të transportuar është 23,580 ndërsa shuma e të hyrave nga shitja e biletave dhe ID kartelat është 26,301.6 me TVSH dhe 22.289.14 € pa TVSH. Krahasuar me periudhën e njëjtë raportuese të vitit 2024, numri i udhëtarëve në TM4 2025 është për 5,266 udhëtarë më shumë, shprehur në përqindje 28.75 %, më shumë. Krahasuar me planifikimin, numri i udhëtarëve të transportuar është për 1,580 udhëtarë më shumë, shprehur në përqindje, +7.18 %. Ndërsa, realizimi financiar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është për 10,101.37 € më shumë, apo + 37.51 %, ndërsa krahasuar me planifikimin, të hyrat për këtë periudhë raportuese janë për + 9,301.6 € më shumë, apo shprehur në përqindje + 31.11 %.

Në pjesën në vijim të këtij raporti paraqesim në formë tabelore performancën operative dhe financiare në transportin e udhëtarëve për periudhën Tetor-Dhjetor 2025 si dhe të dhënat krahasuese me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, dhe planifikimin për periudhën raportuese në TM4 2025:

*Sqarim : në numrin total të udhëtarëve nuk janë të përfshira kategoritë e liruar nga pagesa, këto kategori nuk paguajnë biletë ,mirëpo janë kategori të cilat frekuentojnë mjaft shumë transportin hekurudhor.*

Të dhënat për numrin e udhëtarëve për periudhën TM4 2025							
Përshkrimi	Realizim TM4 2024	Realizimi TM4 2025	Planifikim TM4 2025	Dallimi: Realizim TM4 2025 TM4 2024	Dallimi: Realizim - planifikim TM4 2025	Dallimi në %: TM4 2025 – TM4 2024	Dallimi në %: Realizim - planifikim TM4 2025
Tetor - Dhjetor	18,314	23,580	22,000	+5,266	+1,580	+28.75%	+7.18 %

Tabela Nr. 4.1

Të dhënat për realizimin financiar në transportin e udhëtarëve për periudhën TM4 2025							
Përshkrimi	Realizimi TM4 2024	Realizimi TM4 2025	Planifikimi TM4 2025	Dallimi: Realizim TM4 2025 TM4 2024	Dallimi: Realizim - planifikim TM4 2025	Dallimi në %: TM4 2025 – TM4 2024	Dallimi në %: Realizim - planifikim TM4 2025
Tetor - Dhjetor	16,209.23	22,289.14	17,000	+10,101.37	+9,301.60	+37.51%	+31.11%

Tabela Nr. 4.2

Siç shihet nga të dhënat e paraqitura më lart, sa i përket transportit të udhëtarëve për këtë periudhë kohore kemi pasur një numër më të madhë të udhëtarëve krahasuar me vitin e kaluar dhe me planifikimin.

#### IV.2 Numri i trenave, tren kilometër (t/km) dhe udhëtarë kilometër (u/km)

Numri i trenave të udhëtarëve për këtë periudhë tremujore gjithsej ka qenë **549 të realizuar dhe 2 të revokuar**. Numri i përgjithshëm i udhëtarëve për kilometër (**udhëtar/kilometër**) ka qenë **999,768.42** Sa i përket totalit të kilometrave të zhvilluara nga të gjithë trenat e transportit të udhëtarëve (tren/km) ka qenë **33,552.00**

**V/kom 40.90 km/h.**

#### IV.3. Vonesat e trenave të udhëtarëve

Prej 549 trenave që kanë operuar në këtë periudhë raportuese vonesat e shkaktuara janë pasqyruar në tabelën në vijim:

Shkaku i vonesave	Minuta	Në përqindje (%)
Lokomotiva HM	0	0
Vazhdimi i udhëtimit	0	0
Kryqëzimet	0	0
Lokomotiva/GM defekt	0	0
Lidhja me trenin	0	0
Bashkëngjitja e vagonëve/tërheqja e mjeteve	0	0
Doganë + Polici	0	0
Pritje në garniturë	0	0
Aksidente	0	0
Në nisje	281	8.58 %
Në arritje	2995	91.42 %
Të tjera	0	0
<b>Total vonesat</b>	<b>3,276</b>	<b>100 %</b>

Tabela Nr. 4.3

## V. TRANSPORTI I MALLRAVE

### V.1. Pasqyra e Performancës Operative dhe Financiare në TM4

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim indikatorët fizikë të performancës operative në transportin e mallrave për periudhën Tetor – Dhjetor 2025 si dhe do të bëhet krahasimi me planifikimin dhe me realizimin për periudhën e njëjtë të vitit 2024.

Gjatë periudhës Tetor – Dhjetor 2025 TM4 nuk është realizuar fare transport, krahasuar me periudhën e njëjtë raportuese të vitit 2024 ,në TM4 nuk ka pasur transport pra 0.00, neto-tonë mallra, ndërsa shuma e të hyrave nga ky transport ka qenë 0,00€. Mirëpo ,nëse krahasojmë realizimin me planifikim në periudhën e njëjtë raportuese të vitit 2025, në TM4 , nuk është realizuar transport,pra 0.00% e planifikimit ,ndërsa ne TM4,2024 janë 0,00 neto ton mallra apo shprehur në përqindje nuk është realizuar transport pra 0,00% i planifikimit.Sa i përket realizimi financiar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ,gjatë raportimit në TM4-2025 është një hyrje financiare në vlerë 785.00€, pa TVSH e cila përfaqëson pagës avanc për 250 ton, ndërsa realizimi i shërbimit të transportit është bërë 17.01.2026. Ndërsa krahasuar me planifikim janë - 243,215 €, apo shprehur në përqindje 0.31%,të realizimit financiar të parashikuar.

Në pjesën në vijim të këtij raporti paraqesim në formë tabelore dhe përmes diagrameve performancën operative dhe financiare në transportin e mallrave për periudhën Tetor – Dhjetor 2025 si dhe të dhënat krahasuese me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar si dhe me planifikimin për periudhën raportuese në TM4 2025.

Realizimi në transportin e mallrave:

Tetor Dhjetor-2025	Realizimi Neto Ton 2024	Realizim i Neto Ton 2025	Planifikimi Neto Ton 2025	Dallimi Realizim 2025/2024	Dallimi Realizim-Planifikim 2025	Dallimi Realizim 2025/2024 (%)	Dallimi Realizim-Planifikim 2025(%)
Sasia e transportuar	0.00	0.00	105,000	0.00	-105,000	0.00	0.00

Tabela 5.1


Siç mund të shihet nga tabela 5.1, transporti nuk është realizuar 0.00% të planifikimit.

Transporti i mallrave me kontejnerë për periudhën Tetor - Dhjetor 2025 ka qenë:

Numri i transportuar i kontejnerëve	Kontejnerë të plotë 2025	Kontejnerë të zbrazët 2025
Sasia	0.00	0.00

Tabela 5.2

**Sasia e transportuar në neto-ton për periudhën Tetor – Dhjetor 2025 në formë diagrami:**



**Figura 5.1**

Siç mund të shihet nga figura 5.1 në aspektin operativ nuk kemi arritur të realizojmë transportin e planifikuar për periudhën Tetor - Dhjetor 2025.


Të hyrat nga transporti i mallrave për periudhën raportuese janë:

Të hyrat Tetor - Dhjetor 2025	Realizim shitje të hyra 2024	Realizim shitje të hyra 2025	Planifikim 2025	Dallimi në Realizim 2025/2024	Realizim-Planifikim 2025	Realizim 2025/2024 (%)	Realizim-Planifikim 2025 (%)
Vlera €	0.00	1,985.00	244,000.00	1,985.00	-242,015.00	100%	0.82%

**Tabela 5.3**

Siç mund të shihet nga tabela më lart, të hyra kemi pasur fare pak nuk kemi arritur të realizojmë transportin e planifikuar për periudhën Tetor - Dhjetor 2025.

**Të hyrat në periudhën Korrik-Shtator 2024 në formë diagrami:**



**Figura 5.**

**Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i mallrave:**

Të hyrat dhe shpenzimet	Shitjet/të hyrat në TM	Të ardhura tjera nga TM	Total shitjet	Shpenzim et direkte në TM	Shpenzim et indirekte në TM	Total Shpenzim et	Fitimi/humbja operative	Fitimi/humbja në %
Vlera €	0.00	1,985.00	1,985.00	73,925.99	1,226.00	75,151.99	(73,166.99)	-36.86

**Tabela 5.4**

Transporti i Mallrave në kostot indirekte ka marrë 3.65% të shpenzimeve në total të kompanisë kjo vjen nga ndarja e shpenzimeve me transportin e udhëtarëve në bazë të përqindjes së marrjes pjesë me trena (*tren kilometër*) në komunikacion.

**V.2. Shfrytëzimi i trenave**

Për shkak të punimeve në Linjën e 10-të Hekurudhore, në relacionin Fushë Kosovë - Hani i Elezit, linja ka qenë e mbyllur gjatë gjithë kohës, Ndërsa, transporti vendor nuk është realizuar sipas planifikimeve, për shkak të mos fillimit të transportit të xehes nga Ferronikeli.

Tetor – Dhjetor 2025	Trena të planifikuar	Trena të shfrytëzuar	Shfrytëzim/Planifikim në % 2025
Import	0	0	0.00%
Export	0	0	0.00%
Vendor	228	0	0.00%
Total	228	0	0.00%

**Tabela 5.5**

### V.3. Efektiviteti i trenave

Tetor – Dhjetor 2025	Pesha max. bartëse t/tren	Mesatarja e çdo treni - bt	Efektiviteti (%)
Import	1200	0.00	0.00 %
Eksport	1200	0.00	0.00 %
Vendor	1400	0.00	0.00 %

Tabela 5.6

### V.4. Neto-ton & neto-ton kilometër të transportuar

Neto ton	Realizim Tetor–Dhjetor 2025	Planifikim Tetor–Dhjetor 2025	Realizim/Pla nifikim 2025 në %	Neto ton kilometër	Humbje Planifikim/Realizim 2025 (ton)
Import	0	0.00	0.00 %	0.00	0.00
Export	0	0.00	0.00 %	0.00	0.00
Vendor	0	105,000	0.00 %	0.00	-105,000
Total	0	105,000	0.00 %	0.00	-105,000

Tabela 5.7

Organizimi i tërheqjes me lokomotiva dhe manovruese – shpenzimet e naftës dhe kilometrat e kaluara:

Tabela 5.8

Shpenzimet e lokomotivave tërheqëse dhe manovruese -Transporti i mallrave Tetor –Dhjetor-2025							
Muaji	Shp/km	2640-007	2640-008	2710-009	2640-010	2760-001	Totali
Tetor	Shp.Naftë	0.00	1,900	0.00	0.00	0.00	1,900
	Kilometrat	0.00	298	0.00	0.00	0.00	298
	Nafta /km	0.00	6.37	0.00	0.00	0.00	6.37
Nëntor	Shp.Naftë	0.00	1,500	0.00	0.00	0.00	1,500
	Kilometrat	0.00	618	0.00	0.00	0.00	618
	Nafta /km	0.00	2.43	0.00	0.00	0.00	2.43
Dhjetor	Shp.Naftë	0.00	1,100	0.00	0.00	0.00	1,100
	Kilometrat	175	232	0.00	0.00	0.00	401
	Nafta /km	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Tetor Dhjetor- 2025	Shp.Naftë	0.00	4,500	0.00	0.00	0.00	4,500
	Kilometrat	0.00	1,148	0.00	0.00	0.00	1,148
	Nafta /km	0.00	3.91	0.00	0.00	0.00	3.91

### V.5. Revokimi i trenave

Gjatë periudhës Tetor - Dhjetor 2025 ka pasur revokime të trenave të planifikuar, të cilat pasqyrohen në tabelën në vijim sipas kategorive të ndara në transportin ndërkombëtar (import-export) dhe transport vendor:

Tetor-Dhjetor 2025	Trena të revokuar me 0%	Trena të revokuar me 10%	Trena të revokuar me 20%	Trena të revokuar me 100%	Vlera në euro e revokimeve
Import-Export	80	0	0	0	0.00 €
Vendor	228	0	0	0	0.00 €
Total	308	0	0	0	0.00 €

Tabela 5.9

## VI. ZYRA E MIRËMBAJTJES SË MJETEVE LËVIZËSE – MML

### VI.1. Pasqyra e performancës operative

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim performancën gjatë periudhës 01 Tetor 2025 – 31 Dhjetor 2025, duke krahasuar me realizimin e tre mujorin të katërt (TM4) të vitit 2024.

### VI.2. Sektori i mirëmbajtjes

Në Zyrën e Mirëmbajtjes së Mjeteve Lëvizëse përfshihen:

Mirëmbajtja e trenave motorik, mirëmbajtja e lokomotivave transportuese, mirëmbajtja e lokomotivave manovruese, mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtarëve, mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave dhe punë të tjera për riparimin e vagonëve të huaj.

### VI.3. Mirëmbajtja e trenave motorik

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e trenave motorik të realizuara në periudhën Tetor - Dhjetor 2025 krahasuar me periudhën Tetor – Dhjetor 2024.

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Tetor - Dhjetor 2025	Tetor - Dhjetor 2024	Ndryshimi
1.	Servisime	0	0	0
2.	Riparime	0	0	0
3.	Kontrollime K1	0	0	0
4.	Kontrollime K6	0	0	0

Tabela 6.1

### VI.4. Mirëmbajtja e Lokomotivave Transportuese

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e lokomotivave transportuese të realizuara në periudhën Tetor - Dhjetor 2025 krahasuar me periudhën Tetor - Dhjetor 2024.

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Tetor - Dhjetor 2025	Tetor - Dhjetor 2024	Ndryshimi
1.	Servisime	87	105	-18
2.	Riparime	9	8	+1
3.	Kontrollime K1	5	8	-3
4.	Kontrollime K3	3	2	+1
5.	Kontrollime K6	0	2	-2
6.	Gdhendja e rrotave	0	0	0

Tabela 6.2

### VI.5. Mirëmbajtja e Lokomotivave Manovruese

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e lokomotivave manovruese të realizuara në periudhën Tetor - Dhjetor 2025 krahasuar me periudhën Tetor - Dhjetor 2024.

	Lloji i Riparimit/Mirëmbajtjes	Tetor - Dhjetor 2025	Tetor - Dhjetor 2024	Ndryshimi
1.	Servisime	0	2	-2
2.	Riparime	0	3	-3
3.	Kontrollime K1	2	2	0
4.	Kontrollime K3	1	1	0
5.	Kontrollime K6	0	0	0

Tabela 6.3

### VI.6. Intervenimet në mjetet tërheqëse

Intervenimet në mjetet tërheqëse gjatë periudhës tre mujore (Tetor - Dhjetor 2025) për secilin mjet tërheqës është dhënë në tabelën në vazhdim:

Mjetet tërheqëse (Nr.)	2620 005	2640 007	2640 008	2710 009	2640 010	2620 0016	2760 001	2760 002	5800 004
Servisime (S)	0	1	6	0	0	80	0	0	0
Riparime (R)	3	0	1	0	0	5	0	0	0
Kontrollime (K 1)	0	1	2	0	0	2	2	0	0
Kontrollime (K 3)	0	1	1	0	0	1	1	0	0
Kontrollime (K 6)	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gdhendje të rrotave	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Tabela 6.4

Servisime – S

Riparime - R

Kontrollime njëmuajor – K1

Kontrollime tremujor – K3

Kontrollime gjashtëmuajor – K6

### VI.7. Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtarëve

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimeve të komponentëve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve të udhëtarëve realizuar në periudhën Tetor - Dhjetor 2025, krahasuar me periudhën Tetor – Dhjetor 2024.

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Tetor- Dhjetor 2025	Tetor- Dhjetor 2024	Ndryshimi
1.	Kontrollime (K1)	9	12	-3
2.	Riparim në punëtori	7	16	-9
3.	Gdhendje të rrotave	1	0	+1
4.	Testim i komponentëve	0	0	0
5.	Riparim në stacion	0	0	0

**Tabela 6.5**

### VI.8. Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testeve të komponentëve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve të mallrave të realizuar në periudhën Tetor - Dhjetor 2025, krahasuar me periudhën Tetor - Dhjetor 2024.

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Tetor- Dhjetor 2025	Tetor- Dhjetor 2024	Ndryshimi
1.	Kontrollime K3	0	0	0
2.	Riparim në punëtori	0	0	0
3.	Riparim në teren	0	0	0
4.	Gdhendje të rrotave	0	0	0

**Tabela 6.6**

### VI.9. Riparimi i vagonëve të huaj

Në tabelën nr.6.7, janë paraqitur vlerat e punëve të kryera për periudhën Tetor - Dhjetor 2025 dhe është krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024.

Riparimi/mirëmbajtja e vagonëve të huaj	Tetor- Dhjetor 2025	Tetor- Dhjetor 2024
NewCo Ferronikeli	00.00 €	00.00 €
Vagon të huaj	00.00 €	00.00 €

**Tabela 6.7**

## VII. PROJEKTET DHE PROKURIMI

### VII.1. Projektet kapitale për periudhën Tetor – Dhjetor 2025

Në tabelën 7.1 janë paraqitur projektet të cilat janë zhvilluar gjatë periudhës Tetor - Dhjetor.

Nr	Titulli i aktivitetit të prokurimit	Vlera e parashikuar e kontratës	Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat.	Koment	Periudha Tre (3) mujore
1	Shërbimet e mirëmbajtjes së sistemit financiar PLANET Accounting	10,800.00	10,800.00	Në implementim	TM1 2024
2	Shërbimet e Auditimit të pasqyrave Financiare për vitin 2023, 2024, 2025	9,500.00	7,839.97	Në implementim	TM1 2023
3	Furnizimi me modul kontrolle për diesel motor te tipit 8-710G3B-2	12,000.00	9,971.00	Anuluar	TM2
4	Furnizimi me pajisje dhe pjese rezerve për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse (Furnizim me filtra për lokomotiva)	16,000.00	15,147.36	Përfunduar	TM1
5	Furnizimi me pajisje dhe pjese rezerve për MML II (Furnizimi me xhama për vagonë te udhëtareve)	14,000.00	13,196.47	Përfunduar	TM1
6	Furnizimi me modul për lokomotivën G1700	6,500.00	6,485.28	Përfunduar	TM1
7	Furnizim me modul TH14 për lokomotivën GM 645	7,500.00	4,472.20	Përfunduar	TM1

8	Furnizimi me laptop për nevoja te Bordit te Drejtoreve te Trainkos Sha	2,400.00	1,090.00	Përfunduar	TM1
9	Riparimi i frenueseve indirekte Westinghouse 26C për lokomotivën GM G16 (661)	6,500.00	6,431.00	Përfunduar	TM2
10	Furnizimi me material Higjienik	50000	1,482.73	Në procedurë	TM1
11	Furnizimi me brusha për lokomotivën 645	3,800.00	2,478.00	Përfunduar	TM1
12	Furnizimi me materiale administrative	3,300.00	2,444.02	Kontraktuar	TM1
13	Furnizimi me toner për nevoja te Trainkos Sha	1,400.00	1,299.01	Kontraktuar	TM1
14	Riparimi i mesëm i vagonëve të transportit të udhëtarëve	365,420.00		Anuluar	TM2
15	Ndërrimi i rrotave për lokomotivën 645 016	100,000.00	97,309.51	Kontraktuar	TM2
16	Rregullimi i Automjetit Hyundai X35	850.00	916.00	Kontraktuar	TM2
17	Furnizimi me fshesë elektrike për pastrimin e vagonëve	500.00		Anuluar	TM2
18	Furnizimi me injektor për motor 645 E3 te lokomotivave GT22HW-2	7,000.00	6,159.60	Përfunduar	TM2
19	Shërbimet e sigurimit të palëve të treta	2,000.00	1,982.40	Kontraktuar	TM2
20	Furnizim me klime 18 she	650.00	650	Kontraktuar	TM2

21	Furnizimi me printer skaner 4ne1	260.00	260	Kontraktuar	TM2
22	Furnizimi me ujë të pijshëm në bidon 10 L	990.00	900	Kontraktuar	TM3
23	Matja e Kënaqshmërisë së Klientëve në Transportin e Mallrave dhe të Udhëtarëve	870.00	844	Kontraktuar	TM3
24	Shërbimet e mirëmbajtjes se domenit dhe hostit për vitin 2025	500.00		Anuluar	TM2
25	Furnizimi me pajisje dhe pjesë rezervë për MML. Furnizimi me çelësa specialë për demontimin dhe montimin e kokave të lokomotivave të tipit 661 dhe 645.	6,500.00	6,018.00	Kontraktuar	TM3
26	Mirëmbajtja e Infrastrukturës kryesore të IT-së	24,000.00	23,998.36	Kontraktuar	TM3
27	Furnizimi dhe Riparimi me pajisje dhe pjesë rezervë për MML, Lot1 Furnizimi me siguresa stratusese per lokomotiva 400Am x25 V. Lot 2, Furnzimi me kontktor te kyeqjes	3,800.00		Anuluar	TM3
28	Shërbimet e mirëmbajtjes se domenit dhe hostit për vitin 2025	500.00	500.00	Kontraktuar	TM3

29	Ndërrimi i rrotave për lokomotivën 645 2620-005	100,000.00		Në OSHP	TM4
30	Furnizimi dhe instalimi i gjeneratorit statik me kapacitet 150 kW	17,000.00	11,870.80	Përfunduar	TM4
31	Investim ne asete Kapitale-Transport specifik i 5 vagonëve të udhëtarëve (me makineri të rëndë)	64,036.00		Pezulluar	TM4
32	Furnizimi me bateri startuese plumbi për lokomotiva.	30,000.00	19,993.92	Kontraktuar	TM4
33	Furnizimi me bateri për vagonë të transportit të udhëtarëve	26,000.00	16,595.52	Kontraktuar	TM4
34	Furnizimi me rroba dhe mjete mbrojtëse për punëtorë	24,000.00	27,144.13	Kontraktuar	TM4
35	Shërbimet e abonimit te arkave fiskale	4,500.00	4,319.98	Kontraktuar	TM4
36	Furnizim me rregullator ngacmimi statik për gjeneratorin KATO në lokomotivën 645	9,000.00	8,979.80	Kontraktuar	TM4
37	Furnizim me 5 sete komplet të diktunave për frenues indirekt Westinghouse 26C	4,000.00		Publikuar	TM4
38	Shërbimet e shtypjes se orarit te lëvizjes se trenave (OLT)	300.00	194.70	Në Implementim	TM4
39	Furnizimi me materiale promovuese për fundvit	990.00	837.80	Në Implementim	TM4

40	Riparim i frenuesve indirekt Westinghouse 26C për lokomotivat GM G16 (661)	7,000.00		Publikuar	TM4
----	--	----------	--	-----------	-----

1. **Shërbimet e mirëmbajtjes se sistemit financiar PLANET Accounting-** është nënshkruar kontrata më datën 10.01.2024 dhe është projekt për 3 vite, është procedurë e negociuar pa publikim.
2. **Shërbimet e Auditimit të pasqyrave Financiare për vitin 2023, 2024, 2025** - Projekti është kontraktuar për periudhë tre vjeçare dhe është në zbatim e sipër. Operatori Ekonomik ka përfunduar pjesën e dytë të kontratës për auditim të pasqyrave financiare për vitin 2024 dhe e njëjta është faturuar.
3. **Furnizimi me modul kontrole për diesel motor te tipit 8-710G3B-2** O.E është tërhequr nga kontrata dhe jemi detyruar për të shkuar në anulim.
4. **Furnizimi me pajisje dhe pjesë rezerve për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse (Furnizim me filtra për lokomotiva)-** Projekti ka përfunduar.
5. **Furnizimi me pajisje dhe pjesë rezervë për MML II (Furnizimi me xhama për vagonë të udhëtarëve)-** projekti ka përfunduar dhe është pranuar fatura dhe është dërguar për pagesë.
6. **Furnizimi me modul për lokomotivën G1700-** projekti ka përfunduar.
7. **Furnizim me modul TH14 për lokomotivën GM 645** – është pranuar nga komisioni teknik dhe fatura është dërguar për pagesë.
8. **Furnizimi me laptop për nevoja të Bordit të Drejtoreve të Trainkos Sha** – është pranuar nga komisioni teknik dhe fatura është dërguar për pagesë.
9. **Riparimi i frenueseve indirekte Westinghouse 26C për lokomotivën GM G16 (661)-** ka ardhur fatura e njëjta është dërguar për procesim të pagesës.
10. **Furnizimi me material Higjienik** - është shpallur oferta fituese me të cilën është nënshkruar kontrata me O.E. PM GROUP SH.P.K. me çmim 1,482.73 €.
11. **Furnizimi me brusha për lokomotivën 645** – është bërë hapja e tenderit kemi pranuar 8 oferta, komisioni i vlerësimit ka marr ofertat për vlerësim. Eshte nënshkruar kontrate me O.E. GETNO L.L.C. ne vlerë 2,478.00 €, projekti ka përfunduar pasi është bërë liferimi i mallit sipas afateve, është shkruar për pagesë.
12. **Furnizimi me materiale administrative** - është nënshkruar kontrata me Operatorin Ekonomik me vlere prej 2,444.02 €.
13. **Furnizimi me toner për nevoja te Trainkos Sha** - është nënshkruar kontrata me Operatorin Ekonomik me vlere 1,299.01 €.
14. **Riparimi i mesëm i vagonëve të transportit të udhëtarëve** - është bërë anulimi i tenderit.
15. **Ndërrimi i rrotave për lokomotivën 645 016** – Projekti ka përfudnuar.
16. **Rregullimi i Automjetit Hyundai X35** - është bërë hapja e tenderit dhe kemi pranuar një oferte nga NTP Auto Bosch me çmim prej 916.00 €. Projekti ka përfunduar.

17. **Furnizimi me fshesë elektrike për pastrimin e vagonëve** – ky projekt është tenderuar dy herë dhe nuk kemi pranuar asnjë ofertë.
18. **Furnizimi me injektor për motor 645 E3 te lokomotivave GT22HW-2** - projekti është pranuar nga komisioni i pranimit teknik dhe fatura është dërguar për pagesë.
19. **Shërbimet e sigurimit të palëve të treta** është nënshkruar kontrata me O.E.
20. **Furnizim me klime 18-she-** kemi pranuar një ofertë dhe e njëjta është shpallur fituese.
21. **Furnizimi me printer skaner 4ne1** - projekti ka përfunduar, fatura është dërguar për pagesë.
22. **Furnizimi me ujë të pijshëm në bidon 10 L** – kemi pranuar një oferta nga Ujë Rogove Sh.P.K., dhe e kemi shpallur fitues, çmimi për bidon është 1.5 €.
23. **Matja e Kënaqshmërisë së Klientëve në Transportin e Mallrave dhe të Udhëtarëve** – kemi pranuar dy ofertues, dhe kemi shpallur fitues ofertuesin UBT me çmim 844.00 €.
24. **Shërbimet e mirëmbajtjes së domenit dhe hostit për vitin 2025** – nuk kemi pranuar asnjë ofertë të përgjegjshme.
25. **Furnizimi me pajisje dhe pjesë rezervë për MML. Furnizimi me çelësa special për demontimin dhe montimin e kokave të lokomotivave të tipit 661 dhe 645.,** projekt menaxheri na ka njoftuar se pajisja ka ardhur, jemi në pritje të raportit të pranimit teknik.
26. **Mirëmbajtja e infrastrukturës kryesore të IT-së,** është nënshkruar kontrata me O.E dhe projekti është në implementim.
27. **Furnizimi dhe Riparimi me pajisje dhe pjesë rezervë për MML, Lot1 Furnizimi me siguresa stresuese për lokomotiva 400Am x25 V. Lot 2, Furnizimi me kontaktor te kyeqjes,** nuk kemi pranuar asnjë ofertë dhe kemi shkuar në anulim.
28. **Shërbimet e mirëmbajtjes se domenit dhe hostit për vitin 2025,** projekti ka përfunduar.
29. **Ndërrimi i rrotave për lokomotivën 645 2620-005,** lënda është në OSHP.
30. **Furnizimi dhe instalimi i gjeneratorit statik me kapacitet 150 kW,** hapja e tenderit është bërë më datën 01.10.2025 dhe kemi pranuar 4 oferta, është zgjedhur oferta më e lire me çmimin 11,870.80 €, lënda është në pezullim për shkak të ankesave të operatorëve të tjerë.
31. **Investim ne asete Kapitale-Transport specifik i 5 vagonëve të udhëtarëve (me makineri të rëndë),** kemi bërë njoftimin për kontratë më datën 17.09.2025, hapja e tenderit është bërë më datën 03.10.2025 dhe kemi pranuar një ofertë në vlerën prej 99,769.00 €, e cila është anuluar për shkak të tejkalimit substancial 55% mbi vlerën e parashikuar, e njëjta është ritenderuar më datën 06.10.2025 dhe do të bëhet hapja e tenderit më datën 24.10.2025. Kemi pranuar dy oferta dhe oferta me çmimin më të lirë është eliminuar edhe të dytën jemi detyruar ta eliminojmë për arsye të tejkalimit të buxhetit të planifikuar prej 40.15 %.
32. **Furnizimi me bateri startuese plumbi për lokomotiva.,** është nënshkruar kontrata me O.E EL PROJEKT SH.P.K., me çmimin prej 19,993.92 eurosh.
33. **Furnizimi me bateri për vagonë të transportit të udhëtarëve,** kemi pranuar 3 oferta dhe kontrata do të nënshkruhet ditëve në vazhdim.
34. **Furnizimi me rroba dhe mjete mbrojtëse për punëtorë,** është nënshkruar kontrata me O.E SANKOS SH.P.K.N me çmim prej 27,144.13 eurosh..

- 35. Shërbimet e abonimit të arkave fiskale**, është nënshkruar kontrata me O.E ENTERNET SH.P.K., me çmim prej 4,319.98 eurosh.
- 36. Furnizim me rregullator ngacmimi statik për gjeneratorin KATO në lokomotivën 645**, është nënshkruar kontrata me O.E DIARI BM SH.P.K, me çmim prej 8,979.80 eurosh.
- 37. Furnizim me 5 sete komplet të diktunave për frenues indirekt Westinghouse 26C**, kemi pranuar një ofertë nga O.E N&B SH.P.K, në vlerë prej 3,822.00 eurosh.
- 38. Shërbimet e shtypjes së orarit të lëvizjes së trenave (OLT)**, kemi pranuar dy oferta nga dy OE: TROTEK SH.P.K., në vlerë prej 243.00 € dhe MEDiatech & PRINT SH.P.K., në vlerë prej 194.70 €.
- 39. Furnizimi me materiale promovuese për fundvit**, kemi pranuar dy oferta nga dy OE: TROTEK SH.P.K., në vlerë prej 875.00 € dhe MEDiatech & PRINT SH.P.K., në vlerë prej 837.80 €.
- 40. Riparim i frenuesve indirekt Westinghouse 26C për lokomotivat GM G16 (661)**, hapja e tenderit do të bëhet më datën 09.01.2026.

## VIII. KONTESTET LIGJORE

Gjatë periudhës kohore Tetor – Dhjetor 2025 nga zyra ligjore e Ndërmarrjes janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për përfaqësim sa më të mirë në çështjet ligjore pranë të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës. Gjatë tre mujorit të katërt të vitit 2025, pranë Gjykatave Themelore dhe Komerciale kanë qenë të caktuara 8 seanca gjyqësore për proceset në të cilat kemi qenë palë në procedurë, qoftë në cilësinë e të paditurës apo të paditëses.

Gjatë tre mujorit të katërt të këtij viti Ndërmarrja në procedurë gjyqësore është përballur dhe ka zhvilluar veprime procedurale në 3 konteste për kompensim dëmi, 2 konteste pune dhe 3 lëndë përmbartimore, 1 lëndë me aktgjykim nga Gjykata Komerciale e Kosovës – dhoma e shkallës së parë ku aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit HK- Trainkos - Sh.A., 1 lëndë me Aktvendim të Gjykatës Themelore në Prishtinë ku caktohet garancia për sigurimin e lëndës dhe detyrohet Trainkos - Sh.A., në afat prej 7 ditëve në xhirlogarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës të deponoi 10,000.00 €, në të kundërtën Gjykata do ta refuzoi propozimin për caktimin e masës së sigurisë, 1 lëndë me Aktvendim nga Gjykata Themelore në Prishtinë ku sipas gjykatës përfundohet procedura përmbartimore nëse në afat prej 6 muajsh kreditori HK - Trainkos - Sh.A., nuk paraqet informata të reja lidhur me çështjen e pezulluar, 1 lëndë me Aktvendim nga Gjykata Themelore në Ferizaj ftohet propozuesi Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A., që në afat prej 3 ditësh ta precizoj propozimin për caktimin e masës duke përcaktuar kërkesën e masës dhe llojin e masës, në qoftëse kthehet e pakorigjuar do të hedhet poshtë padia, 1 lëndë me Aktvendim pranohet revizioni i të paditurës Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A., prishet Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe Aktgjykimi I Gjykatës Themelore në Pejë dhe çështja I kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, kemi pranuar një propozim për përmbartim-urdhër përmbartimor nga përmbartuesi privat, kemi pranuar një Ankesë nga i autorizuari i të paditurit ku me vendimin e Gjykatës Komerciale dhoma e shkallës së parë e ka kthyer në favor të Kompanisë ku ne jemi palë paditëse, kemi pranuar parashtresë për kundërshtim të ekspertizës e cila ka ardhur në favor të Kompanisë.

Gjatë kësaj periudhe kemi dërguar revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës në Prishtinë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, kemi dërguar prapësim kundër urdhërit përmbartimor, kemi dërguar Ankesë në Gjykatën Komerciale në Prishtinë – dhoma e shkallës së parë për Gjykatën Komerciale në Prishtinë – dhoma e shkallës së dytë, kemi dorëzuar propozim për caktimin e masës së sigurisë për Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe gjithashtu një propozim për caktimin e masës së sigurisë për Gjykatën Themelore në Pejë, kemi dorëzuar precizim për masë të sigurisë për Gjykatën Themelore Ferizaj, kemi dërguar përgjigje në padi në Gjykatën Themelore në Fushë Kosovë

### VIII.1. KONTESTET GJYQËSORE PËR VITIN 2025

Hekurudhat e Kosovës-Trainkos Sh.A., gjatë vitit 2025, pritet të ballafaqohen me **62** konteste gjyqësore. Në tabelën më poshtë është pasqyruar numri i kontesteve dhe kategorizimi i tyre për të cilat mund të zhvillohen veprime procedurale dhe mund të përfundohen gjatë vitit 2026:

Nr.	LLOJET E KONTESTEVE	///////
1.	Kontestet e marrëdhënies së punës	13
2.	Kontestet për kompensim të dëmit	25
3.	Kontestet për pagimin e borxhit	4
4.	Kontest nga Konflikti Administrativ	1
5.	Lëndë në procedurë përmbarimore	19
6.	Lëndë në procedurë penale	1
7.	<b>Totali</b>	<b>63</b>

Tabela 8.2

## IX. AKTIVITETET NË PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESIT

### IX.1. Planifikimi dhe zhvillimi i biznesit

Përkundër vazhdimësisë në realizimin e të hyrave nga Marrëveshja e OShP-së (2023 – 2027) për vitin 2025, transporti i planifikuar nga shërbimet për mallra nuk ka ndodhur. Edhe për këtë periudhë ashtu si në pjesën e fundvitit 2024 janë vonesat e përfundimit të punëve që janë duke u zhvilluar në modernizimin e Linjës së 10-të Hekurudhore. Nëse e kemi parasysh se Linja e 10-të hekurudhore është arteria bazë e rrjetit hekurudhorë në dhe nga Kosova atëherë kjo është pengesë esenciale në zhvillimin e biznesit të kompanisë për transport me hekurudhë dhe realizimin e projekteve tjera po ashtu shumë esenciale për të ardhmen. Pritjet tona që Linja të lëshohet në shfrytëzim sipas orareve të paralajmëruara nuk kanë ndodhur, nga kjo vazhdon mosplotësimi i planifikimeve tona për transportin e mallrave dhe udhëtarëve sipas planifikimeve dhe kërkesave që dalin për sektorin hekurudhor nga planifikimet dhe strategjitë e shtetit të Kosovës.

### IX.2. Aktivitetet në transportin e mallrave përgjatë periudhës Tetor – Dhjetor 2025

Nga klientët vendor, me të cilët kemi pasur të nënshkruar aneks kontratë për transport deri më 31.12.2023 ka qenë vetëm një, klienti nuk ka vazhduar kontratën gjatë vitit 2025.

Nr.	Emri i kompanisë	Vendi	Mallrat që transporton
1	NewCo Ferronikeli	Drenas	Xehe të nikelit dhe thëngjill.

Klientët/Partnerët të cilët kanë nënshkruar kontratë transporti me Trainkos Sh.A. për vitin 2025 janë gjithsej tre (3) partnerë. Duhet theksuar se këta partnerë që kanë nënshkruar kontratë

transporti janë ndërkombëtarë, të njëjtit kanë pasur kontratë të nënshkruar edhe në vitin 2024, përjashtimisht klienti/partneri Schenker DB dhe Fershped AD.

### Lista e partnerëve ndërkombëtarë:

Nr	Emri i kompanisë	Vendi	Mallrat që transporton
1	NAVICO SHIPPING DOO	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet
2	CARGO LOGISTC DOO	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet
3	ARGO LOGISTIC INT	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet

### IX.3. Aktivitetet në fushën promovuese gjatë periudhës Tetor – Dhjetor 2025

Përveç aktiviteteve të sipërpërmendura Sektori i Marketingut kryen edhe aktivitete të tjera në fushën promovuese dhe menaxhon buxhetin e shpenzimeve të Sektorit të Marketingut për promovimin e shërbimeve të Trainkos Sh.A. përmes kanaleve të ndryshme të marketingut. Sektori i Marketingut ka qenë gjithmonë në përcjellje të organizimeve grupore të cilat janë aprovuar dhe janë realizuar me vagonë të udhëtarëve, nëpërmjet kërkesave të veçanta për shfrytëzimin e aseteve të Trainkos Sh.A. Po ashtu, gjatë tërë kohës mbajmë kontakte me udhëtar aktual dhe potencial të cilët bëjnë pyetje nëpër rrjetet sociale.

### Kërkesat për shfrytëzim të aseteve, shërbimeve të veçanta gjatë periudhës Tetor – Dhjetor 2025 janë si në vijim:

Nr.	Data e shfrytëzimit	Institucioni	Lloji i Shfrytëzimit
1	9.10.2025	SHFMU “Anton Zako Çajupi” Bardhosh-Prishtinë	Nuk është realizuar
2	13.10.2025	SHFMU “Mileniumi i Tretë” Prishtinë	Vizitë-Udhëtim me tren në relacionin Prishtinë-Pejë - Prishtinë.
3	4.11.2025	Azirifilms	Xhirime për video klip.
4	6.11.2025	Kallxo.com	Video-material mbi udhëtimin me tren
5	12.11.2025	Dragan Smiljanic	Fotografi të vagonëve
6	8.12.2025	SH.F.M.U “Pavarësia”	Vizitë-Udhëtim me tren në relacionin (Prishtinë-Pejë-Prishtinë)
7	9.12.2025	SH.F.M.U “Pavarësia”	Vizitë-Udhëtim me tren në relacionin (Prishtinë-Pejë-Prishtinë)
8	18.12.2025	SH.F.M.U “Mitrush Kuteli”	Vizitë-Udhëtim me tren në relacionin (Prishtinë-Pejë-Prishtinë)

### IX.4. Bashkëpunimi me hekurudhat e vendeve tjera

Vazhdon të mbetet pengesë gjendja aktuale e linjave hekurudhore brenda vendit dhe lidhja me hekurudhat e shteteve në regjion për zhvillimin e biznesit të ndërmarrjes. Vonesat në përfundimin e projekteve për modernizimin e linjave hekurudhore pamundëson edhe shfrytëzimin e potencialit nga Portet Detare dhe Linjave tjera hekurudhore që mundësojnë transportin me hekurudhë me pjesën tjetër të Evropës dhe Botës. Kjo argumenton urgjencën e nevojës për modernizimin e

Linjës së 10-të hekurudhore për të treguar një vazhdimësi në transportin hekurudhorë brenda dhe jashtë vendit. Koordinimi i proceseve dhe përfundimi i projekteve të filluara infrastrukturore mundëson vazhdimin e realizimit të projekteve tjera sipas prioriteteve të përcaktuara dhe mundësive financiare që krijohen.

Për transportin e Lokomotivës Ambasadore Di3.619 në Augsburg (Gjermani) janë marrë veprimet e nevojshme të kërkuara nga përgjegjësit e organizimit të transportit.

Pas një kohe të stërzgjatur dhe në pamundësi të transportit të Lokomotivës Ambasadore në muzeun e Augsburgut zyrtarët e muzeut të Augsburgut janë tërhequr nga kjo iniciativë sidomos me problemet e krijuara nga ana e përfaqësuesve të Hekurudhave Maqedone – Infrastruktura.

#### **IX.5. Pjesëmarrja në iniciativat e BE-së për reforma në transportin hekurudhor përmes Lëvizshmërisë së Qëndrueshme**

Në periudhën raportuese nuk ka pas ndonjë aktivitet direkt që ka të bëjë me iniciativat e BE-së, aktiviteti ka qenë i koncentruar në kërkesat e MMPHI-së për raportet me institucionet e BE-së e që i përkasin TRAINKOS-sit.

#### **IX.6. Koordinimi i proceseve me ARH-në, MMPHI-në dhe institucioneve tjera relevante për proceset që ndërlidhen me këto entitete**

Vazhdojnë angazhimet përhershme në plotësimin e obligimeve ligjore në raport me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Sekretariatit për zbatimin e Traktatit për Transport, Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave (ARH), Ministrinë e Ekonomisë (ME), Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Komisionin për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA). Ndër aktivitetet më të rëndësishme që kanë ndodhur gjatë periudhës raportuese vlen të veçohen:

- Angazhimi kryesorë dhe më i rëndësishëm në periudhën raportuese ka qenë në kompletimin dhe plotësimin e dokumentacionit të domosdoshëm për faturimin e muajit Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2025 të OShP-së mes MMPHI – TRAINKOS Sh.A..
- Departamenti i Sigurisë pranë ARH-së ka njoftuar për fillimin e përgatitjes së Draft Rregullores për vendosjen e masave praktike për lëshimin e certifikatave të vetme të sigurisë për Ndërmarrjet Hekurudhore. Nga kjo si palë e interesit kanë kërkuar nga TRAINKOS-i që ta caktohet një anëtar për grup punues dhe pritet rezultati i punës së këtij grupi punues dhe procedimi i Rregullores për aprovim.
- Në periudhën raportuese Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) duke u bazuar në Rregulloren me Nr.02/2013 për Licencimin e Makinistëve respektivisht në Shtojcën II pika 6.1 në të cilën thuhet se ekzaminimi mjekësor duhet të bëhet se paku çdo 3 vite për makinistët deri

në moshën 55 vjeçare, ndërsa pas moshës 55 vjeçare çdo vit ka kërkuar plotësimin e këtij obligimi nga TRAINKOS-i. Kërkesa e bazuar kërkon të kryhen kontrollimet periodike mjekësore për makinistët sipas listës/tabelës së bashkangjitur e të përgatitur dhe përcjellë nga TRAINKOS-si sipas gjendjes së krijuar, raportet mjekësore janë dërguar para kohës së përcaktuar si afat më datën 28.11.2025.

- Departamenti i Ndërveprueshmërisë dhe Departamenti i Sigurisë brenda ARH-së kanë paralajmëruar për planifikimet e tyre që me datën: 10.11.2025, nga ora 09:30 do të fillojnë me inspektimin vjetor teknik dhe NVR për mjetet lëvizëse të TRAINKOS-it. Për këtë është konfirmuar mbështetja nga TRAINKOS-si dhe është caktuar një zyrtarë për të asistuar inspektorët / zyrtarët e ARH-së gjatë inspektimit.

- Me kërkesën e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) që është duke zhvilluar Anketën e Investimeve në Ndërmarrje Publike për vitin 2024 në tërë territorin e Kosovës është punuar në plotësimin e pyetësorit sipas përzgjedhjes së tyre. Anketa bazohet në Ligjin mbi Statistikat Zyrtare - Ligji Nr. 04/L-36, sipas të cilit jemi të detyruar të plotësojmë informacionet e kërkuara në pyetësor. Për këtë qëllim është punuar intesivisht gjithashtu me qëllim të përfundimit të së njëjtës në kohën e kërkuar nga ASK.

- Përgatitja, konfirmimi dhe dërgimi i statistikave të transportit hekurudhor që do të përfshihen në të dhënat zyrtare për EUROSTAT, sipas kërkesës dhe në koordinim me ESK;

- Përgatitja dhe dorëzimi i rregullt i raporteve mujore për statistikave të transportit të realizuar nga TRAINKOS-i pranë ARH-së.

## **X. Aktivitetet në planifikimin dhe zhvillimin e biznesit**

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2025, HK-Trainkos Sh.A. është përballur me një sërë sfidash që kanë ndikuar drejtpërdrejt në funksionimin dhe performancën operationale të ndërmarrjes. Sfidat më të theksuara përfshijnë:

1. **Ndërprerjet në qarkullim** në linjën Fushë Kosovë – Hani i Elezit për shkak të vonesave në realizimin e projektit për modernizimin e Linjës së 10-të hekurudhore, që po zgjat më shumë se parashikimet fillestare.
2. **Mungesa e mjeteve lëvizëse** – me një flotë të vjetërsuar të lokomotivave dhe vagonëve, transporti i udhëtarëve vazhdon me trena klasike në mungesë të trenave motorikë më efikasë dhe më ekonomikë.
3. **Kufizimet buxhetore**, që pengojnë investimet në rinovimin e flotës dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për udhëtarët dhe mallrat.

4. **Pengesat ligjore dhe institucionale**, përfshirë mungesën e ligjit për sigurinë në komunikacionin hekurudhor dhe boshllëqet në legjislacionin sekondar në sektorin e transportit dhe lejimi i konkurrencës jolohale;
5. **Trashëgimi e rëndë juridike nga ish-Hekurudhat e Kosovës**, me procese gjyqësore të pazgjidhura që pengojnë zhvillimin e qëndrueshëm.
6. **Mosfunksionimi i plotë i rrjetit hekurudhor vendor**, që kufizon zgjerimin e shërbimeve dhe ndikimin ekonomik të hekurudhës.
7. **Mungesë e kuadrit teknik profesional**, përballë një strukture të mbingarkuar me staf administrativ dhe moshë të lartë mesatare të personelit ekzistues.

Vetëm përmes një qasjeje të integruar dhe me mbështetje të qëndrueshme nga institucionet relevante, HK-Trainkos Sh.A. mund të rikthehet në rrugën e zhvillimit dhe të luajë një rol më të rëndësishëm në transportin kombëtar.

**Fushë Kosovë,  
Janar 2026**

**Agron Statovci  
Kryeshef Ekzekutiv**

